



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA" FAKULTETI I ARTEVE

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti I Arteve, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës Tel: +383 38 247 129 • E-mail: arte@uni-pr.edu

Tezat e masterit për diskutim publik e miratuar nga Dega e Artit Dramatik - Moduli: Skenar Filmi/TV

Me datë: 16. 10. 2024

Nr.	Kandidatja	Titulli i temës	Komisioni
1.	Arife Haliti	TEMATIKA E DIVORCIT NË KINEMATOGRAFI Një shqyrtim krahasues në kohë dhe hapësirë	1. Prof.Asoc. Ekrem Xani -Kryetar 2. Prof. Zymber Kelmendi - Anëtar 3. Ass Dr. Emin Emini - Anëtar

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I ARTEVE DRAMATIKE
DEGA E ARTEVE DRAMATIKE
MODULI – SKENAR FILMI/TV



Koncept-propozim për punim të temës së Masterit

TEMATIKA E DIVORCIT NË KINEMATOGRAFI
Një shqyrtim krahasues në kohë dhe hapësirë

(THE THEME OF DIVORCE IN CINEMA
A comparative review across time and space)

Mentor: Prof.Mr. Zymer KERMENDI

Kandidatja: Arife Haliti

Prishtinë, 2024

Shqip

Divorci është një ndër temat e njohura në kinematografi që nga vitet më të hershme e deri më sot. Sa do që është i dhembshëm dhe i papranuar, si fenomen dhe si institucion prek të gjithë popujt, e shtresat e shoqërisë të cilët divorcin e përjetojnë në forma dhe mënyra të ndryshme, kjo si shkak i ndikimit kulturor e historik në të cilin kanë kaluar popujt e ndryshëm, e në vecanti, si ndikim i mentaliteteve të ndryshme të cilat një fenomen të tillë e shohin ndryshe nga njëri vend në tjetrin. Divorci ka pasur një historik interesant trajtimi, pasi në fillim është ndaluar që të shqyrtohet ngase është konsideruar se një temë e tillë kontribuon vetëm në prishjen dhe shpërbërjen strukturore të familjes, por me kalimin e viteve, kjo temë është bërë mjaft e evidente dhe e pranishme edhe në kinematografi dhe nga viti në vit ka marrë forma të ndryshme trajtimi dhe është cilësuar se nuk është më tabu trajtimi i një teme të tillë. Për të shqyrtuar këtë temë në këtë Punim Diplome do të përdoren literatura dhe referenca të ndryshme autoriale si dhe në këtë kuadër do të shqyrtohen filmat: Kramer vs. Kramer 1979 me regji të Robert Brenton, A Separation 2011 me regji të Asghar Farhadi dhe Marriage Story 2019 me regji të Noah Baumbach. Përzgjedhja e filmave të lartëcekur është bërë për disa arsye: Arsyeja e përzgjedhjes së filmit “Kramer vs Kramer” është bërë duke u mbështetur në historikun që ka ky film, e që konsiderohet e vlerësohet si një ndër filmat revolucionar i cili e trajton temën e divorcit, duke i tejkaluar të gjitha normat konvencionale që ishin vendosur deri para asaj periudhe. Përzgjedhja e filmit “A Separation” është bërë me qëllim që të shpërfaqet tematika e divorcit dhe ndikimi i tij edhe në shoqëritë dhe kulturat e Lindjes së Mesme e cila i jep një grusht të fortë normave tradicionale – morale , ndërsa filmi “Marriage Story” është përzgjedhur për ta vënë në sipërfaqe se realiteti i divorcit i prek edhe njerëzit me pushtet e reputacion sic janë çifti i artistëve Nicole dhe Charlie, dy artistë teatri: regjisor dhe aktore, personalitete të famshëm dhe të njohur të cilët nuk “shkëlqyen” në jetën e tyre personale.

English

Divorce is one of the prominent themes in cinematography from the earliest years to the present day. Although it is painful and unacceptable, as a phenomenon and as an institution, it affects all peoples and social strata who experience divorce in various forms and ways, influenced by the cultural and historical contexts through which different peoples have passed. Particularly, the impact of diverse mentalities leads to varying perceptions of such a phenomenon from one country to another. Divorce has had an interesting history of treatment. Initially, it was forbidden to be examined as it was believed that such a topic only contributed to the destruction and disintegration of family structure. However, over the years, this topic has become quite evident and present in cinematography, taking on various forms of treatment and being considered no longer taboo. To explore this topic in this thesis, various literature and authorial references will be used. Within this framework, the films to be examined are: "Kramer vs. Kramer" (1979) directed by Robert Benton, "A Separation" (2011) directed by Asghar Farhadi, and "Marriage Story" (2019) directed by Noah Baumbach. The selection of the aforementioned films has been made for several reasons: The choice of the film "Kramer vs. Kramer" is based on its historical significance, as it is regarded as one of the revolutionary films that addresses the topic of divorce, surpassing all the conventional norms established before that period. The selection of the film "A Separation" aims to showcase the theme of divorce and its impact on societies and cultures in the Middle East, which provides a strong challenge to traditional moral norms. Meanwhile, "Marriage Story" has been chosen to highlight that the reality of divorce also affects powerful and reputable individuals, such as the artistic couple Nicole and Charlie, two theater artists: a director and an actress, who are famous personalities but did not "shine" in their personal lives.